# DËSHMI ARKIVI

**A-466257**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | BE-ja në trevjetorin e sulmit në Banjskë: Serbia të nxjerrë menjëherë para drejtësisë përgjegjësit |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/rajoni/be-ja-ne-trevjetorin-e-it-ne-banjske-serbia-te-nxjerre-menjehere-para-i588137` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 14:08:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 14:05:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1c238d50992a71f2f987044f3fd1ec7e49be60e476c7b187cd181f33fdc7eaf0` |
| TEKSTI | `11221d6cb25b89f19b538c6f58e0656a9bcad1cb0cd005c17e8f7dc606bb92b1` |
| PAMJA | `5b1e86d80497443d38b50f2c0640f423be1bc226b1695177bbfe3322f5901c24` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `3c1522a597ad9c3401a8d6458aaa77365b9401667dd54df0f710e256cfc474c2` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `8e58cd7c2ba18fe8505fde5d6e6dfddc77f272b2048ef5da6967fe3daa743e71` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/3c1522a597ad9c3401a8d6458aaa77365b9401667dd54df0f710e256cfc474c2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# BE-ja në trevjetorin e sulmit në Banjskë: Serbia të nxjerrë menjëherë para drejtësisë përgjegjësit

TemA
24 Shtator 2026, 16:05Rajoni TEMA



Bashkimi Evropian në trevjetorin e sulmit në Banjskë ka rikujtuar se ky ka qenë një kërcënim serioz i sigurisë në rajon dhe ka kërkuar nga Serbia që të veprojë menjëherë për të nxjerrë para drejtësisë përgjegjësit e sulmi.

Këtë e ka thënë zëdhënësi i BE-së, duke përsëritur se Serbia nuk i ka ndërmarrë akoma hapat e nevojshëm për të nxjerrë para drejtësisë ata që gjenden në territorin e saj. Po ashtu, ky zëdhënës ka thënë se kjo çështje ishte ngritur edhe në takimin që Përfaqësuesja e Lartë e BE-së, Kaja Kallas, ka pasur në New York me Presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiç.

“Para tri vitesh, sulmi në Banjskë, më 24 shtator 2023, i kryer nga sulmues serbë të Kosovës, të armatosur, ndaj Policisë së Kosovës, kërcënoi seriozisht sigurinë në rajon. Ky sulm i tmerrshëm mori jetën e një polici dhe la dy të tjerë të plagosur. BE-ja në vazhdimësi ka kërkuar që përgjegjësit për këtë të japin llogari dhe shpreh keqardhje se deri më sot Serbia akoma nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të ndjekur ata që janë në Serbi me aktakuzat përkatëse”, thuhet në përgjigjen e zëdhënësit të BE-së.

“Ne presim që Serbia plotësisht të bashkëpunojë përmes kanaleve të vendosura të asistencës së ndërsjellë. Çështja është në pritje për kohë të gjatë dhe duhet menjëherë të ndiqet nga Serbia. Përfaqësuesja e Lartë e ka ngritur këtë çështje edhe me Presidentin Vuçiç gjatë takimit të tyre në New York”, tha ai më tej.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rubio: Serbia është e përfshirë në "çështje potencialisht problematike dhe shpërthyese"]

13:03 Rajoni / 3 komente

Milatoviç në OKB: Ky është momenti i suksesit të Malit të Zi

11:25 Rajoni

[Tre vjet nga sulmi në Banjskë, Kosova kujton Bunjakun ndërsa kërkon dorëzimin e Radoiçiqit]

09:50 Rajoni

[Vuçiç në OKB, falënderon shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën: I rezistuan presionit për të ndryshuar qëndrim! Bëjini sytë katër kur nënshkruani me fuqitë e mëdha]

08:31 Rajoni / 7 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.